


ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

ELEMENTET E DEMOKRACISË

ISMET (13), RILIND (14), SALI (14), ALBION (14), ALBULENA (13), RINESA (13), BLEONA (14)



Ne sot e kuptuam se cili është roli ynë në demokraci

Demokraci do të thotë paqe. Prandaj, ne si qytetarë të një shteti demokratik siç është Kosova, jetojmë në bazë të elementeve të demokracisë, të cilat janë: paqja, toleranca, solidariteti, barazia, liria, etj. Qytetarët të cilët jetojnë në demokraci kanë disa të drejta e ato janë: e drejta e votës, e drejta e lirisë së shprehjes, e drejta e shkollimit, e drejta e trajtimit të barabartë, etj. Demokracia për herë të parë është shfaqur në kryeqytetin e Greqisë në Athinë, në vitin 507 para erës sonë.

Mirëpo, demokracia në atë kohë nuk ishte e plotë. A e dini pse? Sepse në atë kohë në Greqi nuk kanë pasur të drejtë të votojnë të moshuarit, gratë dhe te varfërit, por vetëm burrat të cilët janë konsideruar të pasur e me shumë pronë. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“, që do të thotë qeverisje.

Të jetosh në demokraci do të thotë kesh të drejta të barabarta. Pra, ne të gjithë jemi të barabartë para ligjit. Në shkollën tonë të gjithë jemi të barabartë, kur është puna tek notimi. Nëse në klasën tonë do të vinte një person nga një vend tjetër, i cili nuk i takon fesë tonë ai do të respektohej si të gjithë të tjerët. Pse duhet të respektohet ai si gjithë të tjerët? Sepse në vendin tonë ka demokraci dhe ne i respektojmë të gjithë.



Ne jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik.



E drejtë e jona e rëndësishme është e drejta e strehimit



Autorët e artikullit



Si duhet të jemi qytetarë aktiv dhe çfarë duhet të dimë për qytetarinë aktive?

Qytetar quhet çdo person, i cili jeton në një shtet të caktuar dhe ka leje qëndrim në atë vend. Ne si qytetarë kemi plot të drejta dhe liri si të drejtën e shkollimit, të drejtën dhe lirinë e shprehjes, të drejtën e barazisë, lirinë e lëvizjes, të drejtën e votës, etj.

Përpos të drejtave, ne kemi edhe përgjegjësi e ato janë: respektimi i të moshuarve, pastrimi i ambientit, respektimi i ligjit, pagimi i taksave, etj. Kurse përgjegjësitë tona si fëmijë janë: respektimi i mësimdhënësve, të mësojmë, dhe të jemi të dëgjueshëm.

Kemi disa forma si qytetarët mund të jenë aktiv. Këto forma janë: pjesëmarrja në protesta paqësore, aktivizimi në OJQ të ndryshme, nënshkrimi i peticioneve, pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për të mirën e vendit tonë, e shumë e shumë mënyra të tjera.

Gjithçka që ne bëjmë do të ketë ndikim në shtetin tonë, prandaj veprimet tona duhet të jenë të matura. Ne i porosisim të gjithë lexuesit tanë që të jenë sa më aktivë në të mirën e vendit tonë, dhe po ashtu të gjithë të punojmë sa më shumë për demokracinë tonë.



Ambienti i pastër - gjysma e shëndetit




Përgjegjësia jonë është pastrimi i ambientit



Ne si qytetarë aktiv

BASHKËVENDOSIM DUKE VOTUAR

GENTRIT (13), DONAT (13), ALTIN (13), ORGES (13), DONART (13), SHQIPE (13), AULONA (13)



Vota është elementi bazë që neve na mundëson të bashkëvendosim për të ardhmen tonë


Po të mos ekzistonin zgjedhjet, ne nuk do të mund të dallonim se cila është më e mira për ne. Të zgjedhësh do të thotë të kesh më shumë se një opsion në dispozicion, pastaj ne mund të zgjedhim opsionin e dëshiruar. Ne si qenie njerëzore çdo ditë bëjmë një ose më shumë zgjedhje, si p.sh. bëjmë zgjedhjen e rrobave që dëshirojmë t'i veshim, apo zgjedhim librat që dëshirojmë t'i lexojmë.

Një zgjedhje që është shumë e rëndësishme për ne si nxënës të klasës së VIII-të, është zgjedhja që do ta bëjmë vitin e ardhshëm. Këtu do të zgjedhim drejtimin që ne do të dëshirojmë, në mes të shumë drejtimeve dhe opsioneve të ndryshme, mirëpo ne jemi ata që do të vendosim. Për të bërë këtë zgjedhje nuk duhet të plotësojmë ndonjë kriter të veçantë, përpos asaj që duhet të jemi nxënës të mirë si dhe të kemi mesatare të lartë të notave.

Pra, siç po e shihni, ne në përditshmërinë tonë çdo ditë bëjmë zgjedhje të cilat kanë rëndësi shumë të madhe për të ardhmen tonë.

Nga nëntitulli mund ta kuptoni se sa e rëndësishme është vota e secilit individ, sepse përmes votës çdo qytetar vendos për të ardhmen e vet.

Qytetarët e Kosovës, të cilët janë mbi moshën 18-vjeçare, kanë të drejtë të marrin pjesë (të votojnë) në zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale. Në zgjedh-



jet qendrore qytetarët i votojnë deputetët që ndryshe quhen përfaqësues të popullit, të cilët kanë mandat 4 vjeçar. Ndërsa në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për kryetarin e komunës dhe asamblenë komunale. Ne, kur të arrijmë moshën e duhur do të votojmë, e ju që jeni mbi 18 vjeç, shfrytëzoheni të drejtën për të votuar. Bëje për veten, bëje për të ardhmen tënde.



Grupi i tretë

SHTËPIA E LIGJEVE

ALBIN (13), LEONIT (13), QILIRIM (14), ALBULENA (14), ALKETA (13), ALBINA (14), ERJON (13)

Në këtë artikull bëhet fjalë për Kuvendin dhe rolin e tij në vendin tonë dhe në përgjithësi

Shteti i Kosovës është një shtet demokratik, ku rolin kryesor në vendimmarrje e ka populli. Të jetosh në demokraci do të thotë të jetosh i lirë, të bësh atë që do dhe të jesh i lirë të zgjedhësh të ardhmen tënde.

Një institucion shumë i rëndësishëm në demokraci është Kuvendi. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore: funksionin legjislativ, kontrollues dhe përfaqësues.

Ka funksion legjislativ sepse miratohen ose nuk miratohen ligjet, ka funksion kontrollues sepse kontrollon Qeverinë e Kosovës, dhe funksion përfaqësues sepse aty punojnë deputetët, të cilët na përfaqësojnë neve. Në Kuvend marrin pjesë 120 deputetë, 10 deputetë nga komuniteti jo shumicë serb, dhe 10 të tjerë nga komunitete të tjera si romë, ashkali, turq, egjiptianë, goranë dhe boshnjakë. Kurse, 100 vende të tjera janë për qytetarët shumicë të Kosovës.


Puna në Kuvend ndahet në komisione parlamentare të cilat shqyrtojnë projektligje. Projektligjet janë ligje të cilat propozohen në Kuvend, ndërsa ligjet janë rregulla që duhet të zbatohen nga qytetarët. Këto komisione ndryshe quhen grupe punuese. Në Kuvend ekzistojnë disa lloje të ndryshme të komisioneve si Komisioni për Arsim, ai për Ekonomi, për të Drejtat e Njeriut, etj. Kuvendi ndryshe njihet si Shtëpia e Popullit dhe mbetet një ndër institucionet më të rëndësishme të vendit.



Një ndër gjërat më të rëndësishme të një vendi demokratik është që të gjithë kanë të drejta të barabarta




Autorët e artikullit „Shtëpia e ligjeve“



NDARJA E PUSHTETIT NË KOSOVË

GRAMOS (13), ARDIT (13), YLBER (13), BAHTIJE (13), ERZA (13), YLL (12), PREMTIM (14)



Ne si gazetarë të demokracisë kemi vendosur t'iu tregojmë për ndarjen e pushtetit në Kosovë

Kosova ka pushtet të ndarë në mes të këtyre institucioneve: Kuvendit, Qeverisë dhe gjykatave. Pushteti në Kosovë ndahet për shkak se duhet ndarë edhe punët. Sikurse ne, nëse dëshirojmë të pastrojmë klasën duhet të ndajmë punët në mënyrë që asnjërit të mos i bie të kryejë shumë punë. Duke u ndarë punët në mes neve, ne ndajmë edhe përgjegjësitë. Në këtë mënyrë ne bëjmë pastrimin e klasës duke mos u lodhur shumë. Në Kosovë kemi tri degë të ndara të pushtetit. Kemi Pushtetin Legjislativ, Pushtetin Ekzekutiv, dhe Pushtetin Gjyqësor. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës bëhet miratimi i ligjeve. Këtë detyrë e bën me 120

deputetë. 100 deputetë janë qytetarë shumicë, ndërsa 20 të tjerë janë qytetarë nga komunitetet jo shumicë. Ata janë komuniteti serb, boshnjak, turk, ashkali, romë, dhe egjiptian.


Pushtetin Ekzekutiv e përbën Qeveria e Kosovës. Aty punojnë Kryeministri dhe ministrat e shumtë. Detyra e Qeverisë është zbatimi dhe ekzekutimi i ligjeve, të cilat janë miratuar më parë nga Kuvendi i Kosovës. Për atë Qeveria quhet institucion ekzekutiv.

Gjykatat përbëjnë pushtetin e tretë, Pushtetin Gjyqësor. Kemi tri lloje të gjykatave: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Të gjitha këto gjykata kanë për detyrë të marrin vendimet në bazë të Kushtetutës së Kosovës.


Këto ligje, të gjithë ne duhet t'i respektojmë në mënyrë që shteti ynë të zhvillohet.




Gazetarët e këtij artikulli




Mendimet tona për ndarjen e pushtetit



Zgjedhjet e lira në demokraci




Detyrat e Kuvendit



Shtëpia e demokracisë



Gjethja me mendimet tona



Demokracia dhe institucionet e saj



Ja si duken gazetarët gjatë punës



Grupi duke punuar



Rrathët me tri pushtetet në Kosovë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ganimete Tërbeshi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: LLukar, Prishtinë